



**GJYKATA SUPREME E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
VRHOVNI SUD REPUBLIKE KOSOVA
SUPREME COURT OF REPUBLIC OF KOSOVA**

C-IV-13-0578

20 shtator 2019

Ankuesi

J.M., Vushtrri
përfaqësuar nga Firma Juridike

Kundër

E paditura

Agjencia Kosovare e Privatizimit, rruga “Agim Ramadani” nr.23, Prishtinë

Për: Palët

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtari Sylejman Shumolli, me 20 shtator 2019, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- 1. REFUZOHET si e pa bazuar Ankesa dhe vërtetohet vendimi i AKP-së – Autoritetit të Likuidimit si i drejtë dhe i bazuar në ligj.**
- 2. Nuk caktohen taksa gjyqësore për ankuesin.**

Rrethanat Faktike dhe Procedurale

Me 18 prill 2013, ankuesi dorëzoi në Dhomën e Posaçme, një ankesë/kërkesë për rishqyrtimin e Vendimit nr. MIT027-0454, të datës 25 shkurt 2013, të Autoritetit të Likuidimit të AKP-së (më tej Autoriteti i Likuidimit ose shkurt AL), duke kërkuar nga gjykata që të anuloi vendimin e atakuar dhe të aprovoj ankesën e ankuesit si dhe të detyroj AKP-në në kompensimin për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në shumë prej 177.00 euro, nga Ndërmarrja Shoqërore (NSH) “L”, (në likuidim). Ankuesi i ka bashkëngjitur ankesës së tij, Vendimin e ankimuar të AL, Autorizimin për përfaqësim dhe Njoftimin e datës 22 korrik 2005 lëshuar nga AKM.

Me 25 gusht 2016, Dhoma e Posaçme ka dërguar urdhër të paditurës që të parashtojë mbrojtje ndaj ankesës brenda një muaji pas pranimit të urdhrit.

Me 07 shtator 2016, e paditura në mbrojtjen e saj të parashtruar kundër ankesës, pohoi se ankesa është dorëzuar jashtë afatit të paraparë ligjor prej 30 ditësh dhe si e tillë duhet të hedhet poshtë si e papranueshme ose të refuzohet si e pabazuar. Ankesa është e pabazuar pasi ankuesit në cilësinë e punëtorit të NSH-së nuk iu kishte ndërprerë marrëdhënia e punës, kjo pasi i njëjti ka vazhduar punën me Ndërmarrjen e Re në kuptim të nenit 3.1 të Marrëveshjes së Zotimeve, e cila e detyron Ndërmarrjen e Re të punësoj 250 punëtorë të NSH-së. Nëse ankuesi do të ishte pushuar nga puna ai nuk do të mund të përfitonte nga zbatimi i nenit 3.1 të marrëveshjes në fjalë. AKP më tej pohon se neni 40.1.6.2 i Shtojcës së Ligjit Nr.04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për Çështjet në lidhje me AKP (më tej Shtojca e Ligjit Nr.04/L-033), ia rezervon të drejtën për dëmshpërblim vetëm atyre punëtorëve marrëdhënia e punës e të cilëve është ndërprerë si pasojë apo në lidhje me një veprim të ndërmarr nga AKP. Andaj i ka propozuar gjykatës refuzimin e ankesës si të pabazuar dhe vërtetimin e vendimit të ankimuar të AL.

Me 19 shtator 2016, Dhoma e Posaçme e dërgoi mbrojtjen e të paditurës për përgjigje te ankuesi. Ankuesi e pranoi me rregull por nuk dorëzoi asnjë përgjigje.

Arsyetimi Ligjor

Ankesa e ankuesit refuzohet si e pabazuar.

Ne bazë të nenit 2.4 dhe nenit 71.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (Ligjit mbi Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të Nenit 76.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, lidhur me Nenin 399 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore, Gjykata konstaton se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr këtë Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 12.1 i Rregullores së UNMIK nr. 2001/27 për Ligjin Themelor të Punës në Kosovë (më tej Ligji Themelor i Punës), i zbatueshëm në kohën e ndërprerjes së marrëdhënies së punës në mes të ankuesit dhe AKP-së, parasheh:

Kontrata e punës mund të shkëputet nga punëdhënësi për shkak të ndryshimeve ekonomike, teknologjike ose strukturale në ndërmarrje. Ndryshimet e tilla paraqesin rastet kur punëdhënësi bën ndryshime në prodhim, në programim, në organizim, në strukturë dhe në teknologji të cilat kërkojnë zvogëlim të numrit të punonjësve. Në rastet kur për këtë arsye largohen nga puna të paktën 50 punonjës konsiderohet se largimi nga puna është i shkallës së gjerë.

Neni 12.2 1 i Ligjit Themelor të Punës parasheh: ‘Në rastet e largimit të shkallës së gjerë nga puna zbatohen dispozitat e mëposhtme:

...

(f) punonjësi nuk mund të largohet nga puna derisa punëdhënësi të mos ia ketë paguar atij një dëmshpërblim të njëkohshëm. Dëmshpërblimi duhet t'i paguhet punonjësit në datën e shkëputjes së kontratës së punës sipas shkallës së mëposhtme:

- (i) prej 2 deri në 4 vjet stazh 1 pagë mujore;
- (ii) prej 5 deri në 9 vjet stazh 2 paga mujore;
- (iii) prej 10 deri në 19 vjet stazh 3 paga mujore;
- (iv) prej 20 deri në 29 vjet stazh 4 paga mujore;
- (v) 30 vjet stazh e më tepër 5 paga mujore dhe

Neni 12.3 i Ligjit në fjalë përcakton se:

Rastet kur punonjësit e larguar nga puna për shkak të falimentimit dhe riorganizimit të administruar nga gjykata nuk i nënshtrohen dispozitave të kësaj rregulloreje.

Gjykata me kujdes ka shqyrtuar të dyja, vendimin në fjalë të AKP-së, si dhe pretendimet e ankuesit. Në këtë drejtim, vendimi i AKP-së thekson se "paditësi ka qenë i punësuar nga Ndërmarrja e Re në përputhje të plotë me Marrëveshjen e Zotimeve. Prandaj, ndryshe nga të qenurit tepriçë e fuqisë punëtore, pas privatizimit, paditësi ka vazhduar marrëdhënien e tij të punës me Ndërmarrjen e Re sipas nenit 3.1 të Marrëveshjes në fjalë, pjesë e privatizimit me spin-off special të NSH "L". Ky fakt i vazhdimit të marrëdhënies së punës ndërmjet ankuesit dhe Ndërmarrjes së Re nuk është kontestuar nga ankuesi dhe kështu gjykata e konsideron atë si një fakt të padiskutueshëm.

Gjykata nuk është e mendimit se dëmshpërblimi jepet si kompensim për shkak të ndërprerjes së parakohshme të punësimit, sepse, te punësimi me kohë të pacaktuar, nuk mund të flasim për ndërprerje të parakohshme, por me tepër si një përfitim social i përcaktuar me ligj me qëllim sigurimin e mjeteve për mbijetesë për familjet e të papunëve. Në këtë rast specifik, ankuesi është pranuar në punë menjëherë nga Ndërmarrja e Re, si një obligim nga marrëveshja që AKP-ja e ka pasur me blerësin e NSH-së, kështu duke mos lënë zbrazëti për ankuesin në mes të punësimit të mëhershëm dhe të riut. Kështu, nuk ka lëshim nga ana e AKP-së që do të mund të arsyetonte pagesën pas largimit nga puna.

Gjykata gjithashtu konstaton se situatat e ndryshme të të punësuarve të NSH "L", të punësuar nga Ndërmarrja e Re pas privatizimit dhe të punëtorët e NSH-së të cilët nuk janë marrë në punë nga Ndërmarrja e Re, kërkojnë tjetër vlerësim ligjor, kështu e drejta në dëmshpërblim nuk mund t'i jepet të dy kategorive. Situatat e ndryshme kërkojnë zgjidhje të ndryshme. Meqë e drejta në dëmshpërblim është përcaktuar me Ligjin Themelor të Punës si e drejtë sociale, është bërë me qëllim të mundësojë mjetet për mbijetesë të familjeve të ish punëtorëve për periudhën e mungesës së punësimit, Gjykata konsideron se vetëm kategoria e punëtorëve që nuk janë marrë në punë nga Ndërmarrja e Re mund të shqyrtohet për të drejtën e dëmshpërblimit dhe ankuesi i përket kategorisë tjetër.

Edhe në qoftë se ne, e konsiderojmë të drejtën për dëmshpërblim si një përmbushje (kompensim) për ndërprerje të parakohshme të një kontrate për marrëdhënie pune me kohë të pacaktuar e jo si përfitim social, baza e ekzistencës e kësaj të drejte duhet të jetë dëmi financiar që u shkaktohet punëtorëve që e kanë humbur punën-dëmin që parashihet me ligj. Por ky supozim nuk është absolut dhe mund të kundërshtohet me dispozitën e dëshmime kundërshtuese. Në rastin në fjalë

fakti i padiskutueshëm se paditësi ishte marrë në punë nga Ndërmarrja e Re është saktësisht dëshmi e tillë kundërshtuese që mbështet konkluzionin se paditësi nuk ka pësuar asnjë dëm dhe si e tillë, është arsye për refuzim nga gjykata të prezumimit ligjor. Kjo gjithashtu do të thotë se nëse paditësi ka pohuar se paga në Ndërmarrjen e Re ishte më e vogël se paga e marrë në NSH, gjykata do të kishte marrë në shqyrtim dhënien e kompensimit për ndryshimin në me të dyjave, për periudhën e specifikuar nga neni 12.2 f) i Ligjit Themelor të Punës në Kosovë.

Njëherit një zgjidhje e tillë është në pajtim edhe me precedentët e DHPGJS-së (C-IV-13-0193, C-IV-13-0366, C-IV-13-0493 dhe AC-I-14-0134) për refuzimin e ankesave për dëmshpërblim nga shkëputja e parakohshme e kontratës së punës për punëtorët që kanë vazhduar punësimin me Ndërmarrjen e Re.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54.1 dhe 74.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Taksat gjyqësore

Në pajtim me nenin 63.1 të Ligjit për Dhomën e Posaçme dhe në bazë të nenit 13.3 të Udhëzimit Administrativ për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) nr. 01/2017, të datës 22 mars 2017, nuk caktohen taksa gjyqësore për ankuesin, pasi që shuma e objektit të kontestit është më e vogël se 1,000 euro.

Këshilla juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Sylejman Shumolli,
Gjyqtar

Urdhër për Zyrën e Regjistrimit:

Dërgo Aktgjykimin tek palët.